



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 78 paragrafi 2, nenin 79, nenin 80, nenin 81 dhe nenin 82 paragrafi 2 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 5 paragrafi c të Ligjit numër 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenin 8 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, nenin 9, nenin 10 paragrafi 1 dhe nenin 25 të Rregullores (QRK) numër 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Udhëzimin Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, shpall:

## KONKURS PËR PRANIM

*(aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar)*

|                           |                            |
|---------------------------|----------------------------|
| <b>Emri i grupit:</b>     | Grupi i Arsimit            |
| <b>Institucioni:</b>      | Komuna e Deçanit           |
| <b>Njësia:</b>            | Drejtoria për Arsim        |
| <b>Lloji i pozitave:</b>  | Nëpunës i Shërbimit Publik |
| <b>Data e njoftimit:</b>  | 07.07.2025                 |
| <b>Afati për aplikim:</b> | 08.07.2025-06.08.2025      |

### 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës si Mësimdhënës/e:

- Të realizojë planin mësimor për vendin përkatës të punës, duke u bazuar në legjislacionin përkatës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor, në përputhje me kurrikulën e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies, aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi;
- Të ketë njohuri për një repertor të gjerë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje t'i aplikojë ato më së miri që i përgjigjen situatës në klasë;
- T'i shfrytëzojë në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion;
- Të planifikojë, udhëheqë dhe të vëzhgojë nxënien dhe sjelljen e secilit nxënë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të krijojë një atmosferë pune dhe disipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit ndaj nxënësve;
- Të kontrollojë me rregull dhe të mbajë evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënë si dhe të jetë në gjendje t'i raportojë prindit apo kujdestarit të fëmijës drejt për progresin e arritur të nxënësit sipas kërkesës;
- Të zgjojë tek nxënësit kureshtjen për të nxënë dhe t'i inkurajojë ata të nxënë në mënyrë të pavarur;
- Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit;
- Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e çdo nxënësi duke realizuar takime individuale me prindër/kujdestarë të fëmijës;
- T'i ndihmojë kolegët për ngritjen e cilësisë së punës;
- Të mbikëqyrë dhe të udhëzojë nxënësit në procesin mësimor;
- Të marrë pjesë në punën e organeve të shkollës;

- p. Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës;
- q. Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës;
- r. Të tregojë respekt, sjellje kolegjiale dhe jo diskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon;
- s. Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës, përfshirë ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhen me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton;
- t. Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore;
- u. I punësuar i është i obliguar të respektojë Kodin e Etikës të Komunës së Deçanit i cili zbatohet për të gjithë zyrtarët publik që janë të punësuar nga Komuna e Deçanit;
- v. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- g. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi;
- h. Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale:

Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

## 4. Pozitat aktualisht të lira:

| Nr. | Titulli i pozitës                                  | Statusi                   | Vendi i punës                                                                                                                                                                       | Koeficienti | Nr. i Pozitave | Kualifikimi                                                        | Kohëzgjatja e kontratës          |
|-----|----------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|----------------|--------------------------------------------------------------------|----------------------------------|
| 1.  | Mësimdhënës/e i/e Fizikës në arsimin fillor        | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Sylë Alaj" Drenoc ( 10 ore)<br>SHFMU "Dëshmorët e Vokshit", Pobergjë ( 10 ore)                                                                                               | E19 -6.10   | 1              | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Bacelor katervjeçar (240 ECTS) | pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 2.  | Mësimdhënës/e i/e Fizikë në arsimin fillor         | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Dëshmorët e Kombit", Strelc i Epërm (8 ore)<br>SHFMU "Isa Boletini", Isniq (2 ore) 10 ore                                                                                    | E19-6.10    | 1              | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Bacelor katervjeçar (240 ECTS) | pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 3.  | Mësimdhënës/e i/e Gjuhë Gjermane në arsimin fillor | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Rexhep Kadrijaj", Rastavice (4ore) SHFMU "Dëshmoret e Vokshit", Pobergjë (4 ore)<br>SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës", Llukë e Epërm (4 ore)<br>SHFMU "Ardhmëria" Beleg (4 | E19-6.10    | 1              | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Bacelor katervjeçar            | pacaktuar (6 muaj pune provuese) |

|     |                                                                     |                        |                                                                                                                                              |          |   |                                                                                       |                                    |
|-----|---------------------------------------------------------------------|------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|---|---------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|
|     |                                                                     |                        | ore) SHFMU "Heronjtë e Dukagjinit", në Glllogjan (4 ore) 20 ore                                                                              |          |   |                                                                                       |                                    |
| 4.  | Mësimdhënës/e i/e Teknologjisë Informativë i arsimit fillor         | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU "Dëshmoret e Vokshit "Pobergjë (8 ore) dhe SHFMU"Kuvendi i Verrave te Llukës" Llukë e Epërm- (6 ore), Esad Mekuli 6 orë 20 orë         | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Bachelori katervjeçar (240 ECTS)                     | pacaktuar (6 muaj pune provuese)   |
| 5.  | Mësimdhënës/e i/e Fizikës ne arsimin fillor                         | Zëvendësim 01.09.2025  | SHFMU "Lidhja e Prizrenit " 16 ore                                                                                                           | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Bachelori katervjeçar (240 ECTS)                     | pacaktuar (6 muaj pune provuese)   |
| 6.  | Mësimdhënës/e i/e Edukatës Qytetare dhe Historisë në arsimit fillor | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU "Isa Boletini" Isniq Edukate Qytetare (14 ore) Histori (4 ore) 18 orë                                                                  | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Sistemi Katervjeçar Bachelori katervjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 7.  | Mësimdhënës/e i/e Matematikës i arsimit fillor                      | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU "Lan Selimi " Lumbardhë (12) ore SHFMU" Bajram Curri" (8) orë Gjithsejtë (20) orë                                                      | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Sistemi Katervjeçar Bachelori katervjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 8.  | Mësimdhënës/e i/e Fizikës ne arsimin fillor                         | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU "Dëshmoret e Baballoqit " ne Baballoq (8 ore) SHFMU"Drita" Gramaqel (8 ore) dhe SHFMU" Esad Mekuli" Maznik ( 4 ore) gjithsej 20 ore    | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Sistemi Katervjeçar Bachelori katervjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 9.  | Mësimdhënës/e i/e Fizikës ne arsimin fillor                         | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU "Rexhep Kadrijaj" Rastavice (8 ore) SHFMU"Drita" Gramaqel (8 ore) dhe SHFMU" Esad Mekuli" Maznik ( 4 ore) Gjithsejtë (20) orë          | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Sistemi Katervjeçar Bachelori katervjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 10. | Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Gjermane                                   | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU" Bajram Curri" Strelle i Eperm (8 ore ) SHFMU"Dëshmoret e Kombit", Strelle I Ulët (4 ore ) SHFMU " Lan Selimi" Lumbardh (8 ore) 20 ore | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Sistemi Katervjeçar Bachelori katervjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 11  | Mësimdhënës/e i/e Matematikës ne arsimin fillor                     | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU "Rexhep Kadrijaj" Rastavice 16 ore SHFMU" Bajram Curi" Strelle i Epërm (4 orë) 20 orë                                                  | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS) Sistemi Katervjeçar                                  | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |

|     |                                                               |                           |                                                                                                                                                          |          |   |                                                                                         |                                    |
|-----|---------------------------------------------------------------|---------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|---|-----------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|
|     |                                                               |                           |                                                                                                                                                          |          |   | Bachelor katërvjeçar<br>(240 ECTS)                                                      |                                    |
| 12. | Mësimdhënës/e i/e Matematikës në arsimin fillor               | Vend i lirë<br>09.10.2025 | SHFMU "Dëshmoret e Baballoqit", Baballoq (16 ore)                                                                                                        | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Sistemi Katërvjeçar Bachelor katërvjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 13. | Mësimdhënës/e i/e Artit Muzikor në arsimin fillor             | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Esa Mekuli", Maznik 4 ore Muzik dhe SHFMU "Sylejman Vokshi", Prilep 4 ore Muzikë dhe SHFMU "Faik Konica" Ratish i Epërm 4 ore Muzik<br><br>12 ore | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Sistemi Katërvjeçar Bachelor katërvjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 14. | Mësimdhënës/e i/e Matematikës në arsimin fillor               | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Esad Mekuli" Maznik 16 ore                                                                                                                        | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Sistemi Katërvjeçar Bachelor katërvjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 15. | Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Gjermane në arsimin e mesme të lartë | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHML "Vëllëzerit Frasheri" Deçan 20 ore                                                                                                                  | E17-6.30 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Sistemi Katërvjeçar Bachelor katërvjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 16. | Mësimdhënës/e i/e Matematikës në arsimin fillor               | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Jusuf Gervalla" Prapaqan Oret 20                                                                                                                  | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Sistemi Katërvjeçar Bachelor katërvjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 17. | Mësimdhënës/e i/e Matematikës në arsimin fillor               | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Jusuf Gervalla" Prapaqan (12) ore dhe SHFMU "Isa Boletini" Isniq (8) ore.                                                                         | E19-6.10 | 1 | Niveli Master arsimor (300 ECTS)<br>Sistemi Katërvjeçar Bachelor katërvjeçar (240 ECTS) | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |

|     |                                                                                       |                           |                                                                                                                 |          |   |                                                                                      |                                    |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|---|--------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|
| 18. | Mësimdhënës/e i/e Teknologjisë Informativë në arsimin fillor                          | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU "Lan Selimi " Lumbardh (16) ore<br><br>SHFMU" Sylejman Vokshi" Prejlep (4) orë<br><br>Gjithsejtë (20 orë) | E19-6.10 | 1 | Niveli Master Arsimor (300 ECTS); Sistemi katërvjeçar; Baçelor katërvjeçar 240 ECTS. | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 19. | Mësimdhënës/e i/e i praktikës profesionale - bashkëpunëtor profesional i infermierisë | Vend i lirë<br>01.09.2025 | IAAP" Tafil Kasumaj" Deçan 20 orë                                                                               | E19-6.10 | 1 | 1.Infermier i Përgjithshëm (master - publik                                          | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |
| 20. | Edukator/e për parashkollor në arsimin fillor                                         | Vend i lirë<br>26.11.2025 | SHFMU" Heronjtë e Dukagjinit", Glllogjan 20 ore                                                                 | E19-6.10 | 1 | Baçelor i Edukimit programi parafillor Fakulteti Mësuesisë                           | E pacaktuar (6 muaj pune provuese) |

**Në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.**

**5. Punët detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore:**

- Ndihmon fëmijët/nxënës në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientimin dhe mobilitetin, pozitën dhe uljen e nxënësve në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-s, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim për pjesëmarrje në lojë, stimulimin e të folurit të gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënës gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevoja fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etiken e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;
- Informacionet në shkollë i trajton plotësisht konfidenciale.

**6. Pozitat e lira për Asistent/e i/e Fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore:**

| Nr. | Titulli i Pozitës                                     | Statusi                   | Vendi i Punës                       | Koeficienti | Nr. i Pozitave | Kualifikimi                                                                           | Kontrata                            |
|-----|-------------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------|-------------|----------------|---------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| 1.  | Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU" Maxhun Çekaj", Irzniq 20 ore | E22-5.50    | 1              | Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të | E pacaktuar (6 muaj pune provues e) |

|    |                                                       |                        |                                                  |          |   |                                                                                                         |                                     |
|----|-------------------------------------------------------|------------------------|--------------------------------------------------|----------|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
|    |                                                       |                        |                                                  |          |   | veçanta arsimore.                                                                                       |                                     |
| 2. | Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU" Dëshmoret e Kombit" Strelle I Ulet 20 ore | E22-5.50 | 1 | Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të veçanta arsimore. | E pacaktuar (6 muaj pune provues e) |
| 3. | Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU" Lidhja e Prizrenit", Deçan 20 ore         | E22-5.50 | 3 | Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të veçanta arsimore. | E pacaktuar (6 muaj pune provues e) |
| 4. | Asistent/e i/e Fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU"Drita" Gramaqel- 20 ore                    | E22-5.50 | 1 | Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të veçanta arsimore. | E pacaktuar (6 muaj pune provues e) |
| 5. | Asistent/e i/e Fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU "Bajram Curri" Strelle I Epërm 20 Ore      | E22-5.50 | 1 | Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të veçanta arsimore  | E pacaktuar (6 muaj pune provues e) |
| 6. | Asistent/e i/e Fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU" Isa Boletini" Isniq 20 ore                | E22-5.50 | 1 | Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të veçanta arsimore. | E pacaktuar (6 muaj pune provues e) |
| 7. | Asistent/e i/e Fëmijëve me nevoja te veçanta arsimore | Vend i lirë 01.09.2025 | SHFMU" Heronjtë e Dukagjinit" Glllogjan Ore      | E225.50  | 1 | Niveli i 5-të (postsekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të veçanta arsimore. | Pacaktuar (6 muaj pune provues e)   |

**Në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.**

## **7. Detyrat dhe përgjegjësitë e psikologut/es:**

- a) Të vlerësojë dhe të interpretojë çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënës dhe zhvillimin psikologjik, social dhe emocional të nxënësve;
- b) Të ofrojë ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë aktorët në shkollë;
- c) Të ofrojë ndihmë në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe të nxënësve të talentuar;
- d) Të zhvillojë intervista me nxënës, mësime dhe prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme, me qëllim të vlerësimit objektiv, dhe propozon e zbaton masa për intervenime psiko- edukative individuale dhe në grup;
- e) Të mbajë lidhjet me arsimtarët lidhur me nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë ose kanë probleme personale;
- f) Të këshillojë nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, për mësim plotësues;
- g) Të këshillojë nxënësit për zgjedhjen e profesionit si dhe ata që kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
- h) Të përgatitë raporte mujore dhe vjetore për drejtorin e shkollës;
- i) Të angazhohet në dy e më shumë shkolla, sipas nevojës (aty ku numri i nxënësve është i vogël);
- j) Të angazhohet në komisionet profesionale;
- k) Të kryejë edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori dhe ato që janë përcaktuar me akte të tjera normative.

## **8. Kriteret e kualifikimit për Psikolog i/e shkolle:**

Psikolog i shkollës – personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në degën e Psikologjisë – drejtimi: Psikologji Shkollore dhe Këshillim, të Fakultetit Filozofik (apo siç është rregulluar më UA 2014 për licencimin e mësime dhe bashkëpunëtorëve profesional).

## **9. Detyrat dhe përgjegjësitë e Pedagog/es:**

- a. Të kujdeset për realizimin dhe përparimin e punës edukative-arsimore;
- b. Të kontribuojë në tejkalimin e problemeve që shfaqen në shkollë, si tek nxënësit, mësime dhe prindërit dhe aktorët e tjerë relevantë;
- c. Të ndihmojë në hartimin dhe zbatimin e planit zhvillimor të shkollës;
- d. Të koordinojë punën e aktiveve profesionale;
- e. Të udhëzojë mësime dhe prindërit në realizimin e veprimtarisë mësimore për zbatimin e metodologjive bashkëkohore;
- f. Të monitorojë (hospitujë) dhe të analizojë procesin mësimor;
- g. Të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet mësime dhe prindërit;
- h. Të ndihmojë nxënësit në njohjen e potencialeve të veta, në socializmin e tyre për tejkalimin e vështirësive në të nxënë;
- i. Të përgatitë raporte profesionale mujore dhe vjetore për drejtorin e shkollës;
- j. Të angazhohet në dy e më shumë shkolla, sipas nevojës (aty ku numri i nxënësve është i vogël);
- k. Të kryejë detyra të tjera, të caktuara nga drejtori dhe ato që janë përcaktuar me akte të tjera normative.

## **10. Detyrat dhe përgjegjësitë e Legopedit/es:**

- a. Ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin e programeve individuale për të vlerësuar nevojat me theks të veçantë për shërbime logopedike, si dhe progresin e fëmijëve/nxënësve;
- b. Korrigjimi i çrregullimeve të të lexuarit dhe të shkruarit si dhe parandalimi i këtyre çrregullimeve të nxënësit/fëmijët;
- c. Ndihmon nxënësit në zhvillimin e të folurit koherent dhe përmisimin e fjalorit;
- d. Ndihmon mësime dhe edukatorët në trajtimin e nxënësve me problem në të folurit;
- e. Ndërton marrëdhënie konstruktive me fëmijët/nxënësit, ndër vepron me ta dhe sipas nevojave individuale vendos pritje sfiduese, por të realizueshme;
- f. Këshillon prindërit, rreth aplikimit të teknikave që mund të përmirësojnë të folurit, po ashtu u jep mundësi takimi me prindër tjerë që përballen me sfida të ngjashme përmes seancave vetë-përkrahëse në shkolla.
- g. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me kontratën e punës, të cilat punë të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga drejtoret e shkollave dhe mbikëqyrësi i DKA-së.

## 11. Pozitat e lira ne Arsim Psikolog/e Pedagog/e dhe Legoped/e:

| Nr. | Titulli i Pozitës                           | Statusi                   | Vendi i Punës                                    | Koeficienti | Nr. i Pozitave | Kualifikimi                                                                                      | Kontrata                                |
|-----|---------------------------------------------|---------------------------|--------------------------------------------------|-------------|----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|
| 1.  | Psikolog/e Shkolle                          | Vend i lirë<br>01.09.2025 | IAAP- “Tafil Kasumaj” Deçan<br>40 ore            | E18-6.20    | 1              | Niveli Master<br>Arsimor (300 ECTS);<br>Sistemi katërvjeçar;<br>Baçelor katërvjeçar<br>240 ECTS. | E pacaktuar<br>(6 muaj pune<br>provues) |
| 2.  | Psikolog/e Shkolle                          | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHML-<br>“Vëllëzerit Frasheri” Deçan<br>40 ore   | E18-6.20    | 1              | Niveli Master<br>Arsimor (300 ECTS);<br>Sistemi katërvjeçar;<br>Baçelor katërvjeçar<br>240 ECTS. | E pacaktuar<br>(6 muaj pune<br>provues) |
| 3.  | Psikolog/e Shkolle                          | Vend i Lirë               | SHFMU”Kuvendi I Verrave të Llukës” Llukë e Epërm | E18-6.20    | 1              | Niveli Master<br>Arsimor (300 ECTS);<br>Sistemi katërvjeçar;<br>Baçelor katërvjeçar<br>240 ECTS. | E pacaktuar<br>(6 muaj pune<br>provues) |
| 4.  | Terapis/e i Gjuhës dhe të Folurit-Legoped/e | Vend i lirë<br>01.09.2025 | SHFMU”Lidhja e Prizrenit” Deçan<br>40 ore        | E18-6.20    | 1              | Niveli Master<br>Arsimor (300 ECTS);<br>Sistemi katërvjeçar;<br>Baçelor katërvjeçar<br>240 ECTS. | E pacaktuar<br>(6 muaj pune<br>provues) |
| 5.  | Pedagog/e Shkolle                           | Vend i Lirë<br>01.09.2025 | SHLM“Vëllëzerit Frasheri”                        | E18-6.20    | 1              | Niveli Master<br>Arsimor (300 ECTS);<br>Sistemi katërvjeçar;<br>Baçelor katërvjeçar<br>240 ECTS. | E pacaktuar<br>(6 muaj pune<br>provues) |

**Në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.**

## 12. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën për Shërbime me Qytetar, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Deçanit si dhe mund të shkarkohet nga ueb faja e Komunës së Deçanit, i plotësuar dorëzohet fizikisht në Zyrën për Shërbime me Qytetar apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Deçanit, Rruga “Jashar Salihu” Nr. 3, 51000 Deçan, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.

## 13. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (*prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur*);
- Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (*prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim*);
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj*);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;

- g. Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për shkelje të rënda të pushuar sipas Ligjit për Zyrtarët Publik;
- h. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- i. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.

***Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.***

**14. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:**

- a. Testimi me shkrim (*përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë*).
- b. Intervista me gojë (*përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm, nga to 30% intervista e strukturuar dhe 20% portfolio profesionale*).

**15. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:**

Përmes ueb faqes së Komunës së Deçanit <https://decan.rks-gov.net/> portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net/>), postën elektronike ose numrin e telefonit të deklaruar në aplikacion.

**Sqarime shtesë:**

- Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë
- Të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi);
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publik;
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk Pranohen.



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore